




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS – SHTIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-13026 /23 datë: 25.05.2023



Npi – 01/218 datë: 26.05.2023

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, Si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/155 datë: 27.04.2023, për mbledhjen e Komitetit për Komunitete të mbajtur më: 26.05.2023, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -V- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE
E mbajtur më: 26.05.2023 (e premte) në ora 14:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi, z.Bajram Ilazi, anëtarët e Komitetit për Komunitete: z.Besnik Seferi, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Mehmeti, z.Arton Demiri, znj.Shkurte Mustafa, dhe znj.Shkurte Behluli. Në mbledhje përveç anëtarëve të Komitetit kanë marrë pjesë edhe: Nga ZKF-ja z.Bujar Ferati.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi z.Bajram Ilazi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2024-2026,
2. Propozim për ndryshimin e nenit 3 të Rregullores për ndarjen e bursave për studentë Npi-01/60 dt.30.03.2012
3. Draft-Programi tre vjeçar për banim social në komunën e Shtimes 2023-2025
4. Të ndryshme.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Besnik Seferi; Përshëndetje, sa i përket KAB-it kjo ka me shkua në diskutim publik, kështu që mundemi me diskutuar gjerë e gjatë. Nuk e di pse është futë si pikë e dytë “ Propozim për ndryshimin e nenit 3 të Rregullores për ndarjen e bursave për studentë Npi-01/60 dt.30.03.2012”, kërkoj sqarim? Për Programin e banimit është mirë që me qenë drejtori i Shëndetësisë prezent dhe me na dhënë sqarime.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Te pika e parë kam menduar që të japim disa sugjerime.

z.Besnik Seferi; Unë propozoj që pika e dytë të ndryshohet dhe të bëhet si vijon: “Propozim-Ndryshim i Rregullores për ndarjen e bursave për Studentë Npi-01/60”

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Konstatoi Kuorumin prej 7 anëtarëve prezent në mbledhje.

***Komiteti për Komunitete, unanimsht miratoi propozimin e z.Besnik Seferit, për ndryshimin e pikës së dytë “Propozim-Ndryshim i Rregullores për ndarjen e bursave për Studentë Npi-01/60”.**

***Komiteti për Komunitete, unanimsht miratoi rendin e ditës me ndryshimin e propozuar nga Besnik Seferi.**

Pika 1

Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2024-2026

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Fjalën për këtë pikë ja dha z.Bujar Feratit.

z.Bujar Ferati – ZKF; Përshëndetje, Draftin e KAB-it e kemi pranuar me datën 15.03.2023 nga Ministria e Financave. Ky pra është drafti i parë mbi bazën e të cilit do të hartohet edhe buxheti i Komunës, por fillimisht më duhet ta qesin në diskutim publik. Deri në muajin shtator është një punë intensive që do ta bëjmë për me e rumbullakuar aprovimin e buxhetit. Në vazhdim lexoi pjesët kryesore të KAB-it për vitin 2024/2026 ku tha se buxheti për vitin 2024 është projektuar që të jetë 9.928.106 euro, mirëpo kjo shifër mundet të ndryshojë deri në miratimin e tije. (shih dokumentin) unë nuk do ta vazhdojë më gjatë por do ti mirëpres pyetjet juaja.

z.Besnik Seferi; Faleminderit Bujar për prezantimin, ky është një draft që duhet të shkojë në diskutim publik. Vitin e kaluar ka pas mjaftë sfida siç ishte rasti në fshatin Gjyrvoc aty mungon ndriçimi, kanalizimi, prandaj unë sugjeroj që ta mbani një debat edhe në fshatin Gjyrvoc në Komunitetin Pakicë, meqenëse i kemi edhe përfaqësuesit e Komunitetit z.Bajram Ilazin dhe z.Muhamet Mehmetin. E kam vërejtë se kanalizimi në Gjyrvoc është ende i hapur dhe ekziston rreziku se mundet të shfaqet një Epidemi.

z.Bujar Ferati – ZKF; Dokumentin e KAB-it e kemi marrë dje kjo për arsye se është dashur me përgatitë draftin final. Duhet të merren parasysh edhe kërkesat që vijnë nga qytetarët por edhe propozimet e drejtorive. Unë ju inkurajoj që të merrni pjesë në diskutim publik si përfaqësues të Komuniteteve.

z.Arton Demiri; Përshëndetje, e kemi një kërkesë që lidhet me rrugën “Ardhmëria”, Trafoja e rrymës që e furnizon këtë rrugë është shumë e dobët, rryma është e tensionit të ulët dhe kanë probleme me pajisje shtëpiake, po bëhet fjalë për 12 shtëpi. Dhe kërkesa tjetër është se në rrugën “Eqrem Qabe” nuk ka ndriçim publik.

z.Bujar Ferati – ZKF; Unë i evidentoj këto kërkesa, mirëpo drejtorit i adresojnë ato për nevojën e futjes në buxhet apo jo.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Unë e kam shikuar pak KAB-in dhe e kam pa se ZKKK-ja e ka buxhetin e njëjtë. Pastaj kemi pas një kërkesë se kjo zyre të ketë tre zyrtarë. Është një shembull i mirë në Ferizaj ku kryetari bashkë me drejtorë shkon i viziton familjet e komunitetit pakicë. Mirë është që këtë ta bëjë edhe kryetari ynë.

z.Bujar Ferati – ZKF; Sa i përket datave për dëgjimet publike do të bëhet një orar ku do të përfshihen fshatrat kryesore edhe ato ku jetojnë komuniteti pakicë, sepse siç e dini fshatrat janë të përzier me banorë.

z.Besnik Seferi; Një propozim i tillë të bëhet vetëm me kryetarin, mendoj se është problem mënyra e organizimit të debateve publike, sepse nuk po ka të interesuar. Ndoshta është e mundur që me u shtuar edhe një projekt.

z.Bujar Ferati – ZKF; Meqenëse është draft tani për tani të gjitha janë të mundura.

z.Arton Demiri; Ne duhet me diskutua mes vete por paraprakisht duhet me dit për datat se kur do të organizohet diskutimi publik. Ne jemi të interesuar me njoftua kryetarin me propozimet tona. Ne e dijmë se kryetari nuk mundet me shkua në çdo lagje.

znj.Rrezartë Ramadani; Përshëndetje, edhe vjet janë bërë dëgjime publike. Ajo që duhet të them është se unë nuk e shoh të arsyeshme për me bë ndasi dhe me bërë një rekomandim të tillë për kryetarin, sepse dëgjimet publike bëhen në vendbanimet kryesore dhe projektet që bëhen janë për interes të gjithë banorëve pa përjashtim.

z.Muhamet Mehmeti; Përshëndetje, ndasia po bëhet gjithherë në nivelin qendrorë siç është rasti në vendet e rezervuara për Komunitetin Serb. Niveli i Arsimit dhe Edukimit në Komunitetin Rom dhe Ashkali është i atillë nuk e din se ku me u drejtua me kërkesat apo ankesat e tyre. Në komunën e Shtimes për fat të mirë nuk ka diskriminim.

*Komiteti për Komunitete, me 6 vota “Për” me 1 votë “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim” vendosi që t’i Rekomandon Kuvendit të Komunës së Shtimes, që të miratoi Draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore për periudhën 2024-2026, me vërejtjen që Kryetari i Komunës së Shtimes së bashku me Drejtorët Komunal kompetent të vizitojnë lagjet e komunitetit pakicë, me qëllim që të marrin kërkesat dhe nevojat e tyre që kanë të bëjnë me miratimin e KAB-in për periudhën 2024-2026.

Pika 2

Propozim për ndryshimin e nenit 3 të Rregullores për ndarjen e bursave për studentë Npi-01/60 dt.30.03.2012

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Besnik Seferi; Te rregullorja për ndarjen e bursave e kemi pas si kriter notën mesatare 7.5. Unë mendojë se nuk është kundër ligjore që me i planifikuar ndarjen në disa bursave për studentët e Komuniteti pakicë edhe pa i plotësuar kriteret sepse siç e dini edhe fëmijët e dëshmorëve kanë marrë bursa pa e plotësuar kriterin e notës 7.5. Unë propozojë që të caktohet një numër i studentëve 3-5 të Komunitetit Pakicë të cilët kishin me marrë bursa. Nëse ky numër nuk plotësohet nga Komunitetit Pakicë atëherë shkojnë për Komunitetin Shumicë. Unë personalisht jam “Kundër” për me iu dhënë bursa studentëve që studiojnë jashtë vendit unë e përkrahu propozimin për me iu rritë shuma e bursës për ata që studiojnë në Kosovë.

znj.Rrezartë Ramadani; Edhe un jam “Kundër” për me iu nda bursa studentëve që studiojnë jashtë, por kjo shumë të ndahet për studentët në Kosovë.

***Komiteti për Komunitete, unanimsht vendosi që t’i rekomandon, Kuvendit të Komunës së Shtimes, që me ndryshimin e Rregullores Komunale për ndarjen e Bursave për Student, të garantohen 5 (pesë) bursa për studentët e komunitetit pakicë.**

***Komiteti për Komunitete me 0 vota “Për” me 6 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim” nuk e miratoi propozimin e Drejtorisë Komunale për Arsim për ndryshimin e nenit 3 të Rregullores Komunale për ndarjen e Bursave për Student, Npi-01/60 të datës 30.03.2012, për të shtuar edhe fjalët: (edhe studentët jashtë vendit).**

Pika 3

Draft-Programi tre vjeçar për banim social në komunën e Shtimes 2023-2025

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Besnik Seferi; Ky program vjen nga niveli qendror i bazuar në kushtetutë, mirëpo se sa do të përmbushet është çështje e diskutueshme.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Këtu po thotë që brenda tri viteve me u caktuar sipas këtij plani një zyrtarë i banimit. Sipas këtij plani kanë me u mbështetë familjet nevojtare sipas viteve. Ky program mundet me iu ndihmua jo vetëm Komunitetit Pakicë por edhe Komunitetit Shumicë.

***Komiteti për Komunitete, unanimsht vendosi që t’i rekomandoi Kuvendit të Komunës së Shtimes, miratimin e Draft-Programit tre vjeçar për banim social në komunën e Shtimes për periudhën 2023-2025.**

Pika 4

Të ndryshme

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Muhamet Mehmeti; Realisht unë sot e kam pritur drejtoreshën e DKA që të vjen në mbledhje dhe ta pyesim për nxënësit e Komuniteteve sepse sivjet në shkollën e mesme shkojnë 11 nxënës.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; E kemi Udhëzimin Administrativ që e përcakton saktësisht numrin prej 5 nxënësve në secilin drejtim të shkollës së mesme.

z.Muhamet Mehmeti; Sa e di unë nxënësit e Komunitetit Pakicë po shkojnë në shkollën profesionale, edhe ata të cilët janë nxënës shumë të mirë e të cilët ishte dashur me i qua ne Infermieri ose drejtimet tjera.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Ne fillimisht duhet të presim se apo pranohen nxënësit në drejtime tjera e tek pastaj ta adresojmë çështjen. Çështja tjetër është se Ibrahim ka shkuar në pension, ne kemi bërë një rekomandim për me e punësuar një zyrtarë aty. Mirë është që edhe ju si anëtarë të Kuvendit me bërë pak presion në Kuvend.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Ju falënderoj për pjesëmarrjen dhe punën, meqenëse diskutime tjera nuk ka mbledhjen e përfundoi në ora 11:55h.

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit
Bajram Ilazi

PËR

